



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CA-2023-02

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 21 mars 2023

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi
Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave gjatë Procedurës së Apelit**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Aleks Uajting

Mbrojtjes së Salih Mustafës:
Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave:
Ani Pues

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”), ka marrë në shqyrtim kërkesën e z. Salih Mustafa (“Mustafa” ose “i akuzuari”) përmes të cilës ai i kërkon Panelit të miratojë lejen për apelimin e Vendimit të tij mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procedurën e Apelit (“Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”) në bazë të nenit 45(2) të Ligjit dhe rregullës 77(2) të Rregullores (“Kërkesa”).² Mbrojtësja e Viktimave dhe Prokurori i Specializuar u përgjigjën përkatësisht më 3 mars 2023 dhe 6 mars 2023 se Kërkesa duhet të hidhet poshtë.³

I. HISTORIKU

1. Më 16 dhjetor 2022, Trupi Gjykses shpalli Aktgjykimin në çështjen gjyqësore KSC-BC-2020-05 (“Aktgjykimi”).⁴ Më 2 shkurt 2023, i akuzuari dorëzoi njoftimin për apel kundër Aktgjykimit.⁵

¹ F00007, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 7 shkurt 2023 (konfidencial, riklasifikuar si publik më 7 shkurt 2023).

² F00013, Kërkesë e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procedurën e Apelit, 22 shkurt 2023 (“Kërkesa”). Shih F00011, Vendim mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procesit të Apelit, 15 shkurt 2023 (“Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”).

³ F00014, Përgjigje e Mbrojtësës së Viktimave ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procedurën e Apelit (F00013), 3 mars 2023 (“Përgjigja e Viktimave”); F00015, Përgjigja e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Modalitetet e Pjesëmarrjes së Viktimave në Procedurën e Apelit, 6 mars 2023 (“Përgjigja e ZPS-së”).

⁴ KSC-BC-2020-05, F00494/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Aktgjykimit, 24 janar 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 16 dhjetor 2022, versioni i pakorrigjuar publik u dorëzua në 19 janar 2023).

⁵ F00006/RED2, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit për Apel të Mbrojtjes në bazë të Rregullës 176 (të Rregullores së Procedurës dhe Provave) kundër Aktgjykimit të Trupit Gjykses I të 16 dhjetorit 2022, 13 shkurt 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 2 shkurt 2023).

2. Më 9 shkurt 2023, Kryegjykatësja planifikoi një konferencë para apelit për datën 16 shkurt 2023, dhe udhëzoi palët dhe mbrojtësen e viktimave ta njoftonin për çdo problem që do të donin të shtronin gjatë asaj seance.⁶ Më 13 shkurt 2023, Mustafa dorëzoi një mocion, *ex parte* mbrojtëses së viktimave, ku argumentonte se nuk kishte bazë ligjore që mbrojtësja e viktimave të merrte pjesë në konferencën para apelit apo më përgjithësisht në procedurën e apelit (“Mocioni mbi Pjesëmarrjen e Viktimave”).⁷

3. Më 15 shkurt 2023, Paneli i Apelit nxori Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, duke hedhur poshtë Mocionin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave dhe duke konstatuar, mes të tjerash, se pjesëmarrja e viktimave në procedurën e apelit është e lejueshme në qoftë se është në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren, kufizohet në aspektet që ndikojnë tek interesat personale të viktimave, dhe nuk cenon apo bie ndesh me të drejtat e të akuzuarit.⁸

II. DISKUTIM

A. PARASHTRIMET E PALËVE

4. Mustafa kërkon nga Dhoma e Gjykatës Supreme e Dhomave të Specializuara (“Gjykata Supreme”) leje për apelimin e Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave sipas nenit 45(2) të Ligjit dhe rregullës 77(2) të Rregullores.⁹ Mes të tjerash, Mustafa, argumenton se, sipas rregullës 173(3) të Rregullores, rregullat dhe nenet e procedurës së gjyimit zbatohen *mutatis mutandis* për procedurën përpara panelit të Gjykatës së Apelit.¹⁰ Ai parashtron se problemi konkret që kërkon zgjidhje nga Gjykata Supreme është nëse Paneli i Apelit “gaboi kur konstatoi se një ndërthurje e nenit 22 (6) [të Ligjit]

⁶ F00008, Urdhër për Caktimin e Datës të Konferencës Para Apelit, 9 shkurt 2023, para. 11.

⁷ F00009, Mocion në lidhje me Pjesëmarrjen e Mbrojtëses së Viktimave në Konferencën Para Apelit dhe në Procedurën e Mëtejshme të Apelit, 13 shkurt 2023 (konfidencial dhe *ex parte*, rriklasifikuar si publik më 15 shkurt 2023), para. 7-17.

⁸ Shih Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 6. Shih gjithashtu Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 5, 7-13.

⁹ Kërkesa, para. 4-13, 24. Shih gjithashtu Kërkesën, para. 14-23.

¹⁰ Kërkesa, para. 4, 8.

dhe rregullave 114 dhe 173(3) [të Rregullores] lejojnë pjesëmarrjen e mbrojtëses së viktimave në procedurën e apelit përpara tij, përveç apeleve sipas nenit 46(9) [të Ligjit].¹¹

5. Mbrojtësja e viktimave dhe ZPS-ja përgjigjen se as Ligji, as Rregullorja nuk parashikojnë apele të ndërmjetme drejtuar Gjykatës Supreme kundër vendimeve të Panelit të Apelit.¹² Në veçanti, ato argumentojnë se, në kundërshtim me parashtrimin e Mustafës, procedura e apelit të ndërmjetëm e përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit nuk zbatohet për fazën e apelit përmes rregullës 173(3) të Rregullores.¹³

6. Mbrojtësja e viktimave parashtron gjithashtu se Mustafa nuk ka respektuar Udhëzuesin e Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet e Protokolluara”) duke e hequr mbrojtësen e viktimave nga ballina e Kërkesës, ku përcaktohet se kujt i shpërndahet një parashtrim i protokolluar, dhe i kërkon Panelit t’i rikujtojë Mbrojtjes që të zbatojë kuadrin ligjor dhe Udhëzuesin e Punës për Parashtrimet e Protokolluara.¹⁴

B. VLERËSIMI I PANELIT TË GJYKATËS SË APELIT

7. Paneli i Apelit rikujton se neni 45(2) i Ligjit trajton apelimet e ndërmjetme, qoftë ato që janë vetiu të lejueshme – ndaj marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me paraburgimin apo me ndonjë parashtrim paraprak kundër juridiksionit të Dhomave të Specializuara – qoftë ato kundër vendimeve, për të cilat kërkohet leje për apelim nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykues.¹⁵ Paneli gjykon se

¹¹ Kërkesa, para. 12.

¹² Përgjigjja e Viktimave, para. 5-13; Përgjigjja e ZPS-së, para. 2-4.

¹³ Përgjigjja e Viktimave, para. 10; Përgjigjja e ZPS-së, para. 3.

¹⁴ Përgjigjja e Viktimave, para. 25-26, 27(b), që i referohet KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019 (“Udhëzuesi i Punës për Parashtrimet”), neni 29(2)(j).

¹⁵ Shih gjithashtu rregullën 77 të Rregullores.

neni 45 nuk parashikon asnjë mundësi për apele të ndërmjetme kundër vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit.¹⁶

8. Për më tepër, për sa u përket opsioneve të mundshme të apelit të vendimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit, Paneli rikujton se neni 47 e ngushton numrin e apeliemeve të shqyrtuara nga Gjykata Supreme vetëm për apelieme kundër aktgjykimeve të Panelit të Gjykatës së Apelit për rastet kur, ose ky i fundit ka prapësuar verdiktin e pafajësisë dhe ka dhënë vendim fajësie, apo kur është vendosur si sanksion penal burgimi i përjetshëm. Paneli rikujton gjithashtu se sipas nenit 48(6) të Ligjit, një palë mund të kërkojë mbrojtjen e ligjshmërisë para Gjykatës Supreme kundër vendimeve të formës së prerë për caktimin apo vazhdimin e paraburgimit. Në Kërkesë nuk është i pranishëm asnjëri nga këta skenarë.

9. Paneli vlerëson se Ligji është i qartë në lidhje me opsionet e mundshme të apelit dhe se megjithëse rregulla 173(3) e Rregullores përcakton se rregullat e procedurës së gjykimit zbatohen *mutatis mutandis* për procedurën e apelit, Paneli gjykon se, kjo dispozitë qartazi nuk mundëson parashtrimet e apeliemeve të ndërmjetme ndaj vendimeve të Panelit të Apelit, sipas rregullës 77(2),. Siç është vënë re me të drejtë nga ZPS-ja dhe mbrojtësja e viktimave, qëllimi i deklaruar i rregullës 77(2) është të sigurojë kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose të rezultatit të gjykimit.¹⁷ Ndryshimet që do të duheshin për të përshtatur rregullën 77(2) të Rregullores për procedurën e apelit do e bënin këtë dispozitë të panjohshme dhe të papajtueshme me natyrën e procedurës së apelit, e cila ka fushëveprim të kufizuar.¹⁸ Rrjedhimisht, nuk ka bazë

¹⁶ Shih gjithashtu IRMCT, *Prosecutor v. Mladić*, MICT-13-56-A, Public Redacted Version of the “Decision on a Motion for Reconsideration and Certification to Appeal Decision on a Request for Provisional Release” filed on 22 May 2018, 8 qershor 2018, pp. 2-3; ICTY, *Prosecutor v. Naletilić and Martinović*, IT-98-34-A, Decision on Naletilić’s Amended Second Rule 115 Motion and Third Rule 115 Motion to Present Additional Evidence, 7 korrik 2005, para. 20; ICTR, *Kajelijeli v. Prosecutor*, ICTR-98-44A-A, Judgement, 23 maj 2005, para. 202.

¹⁷ Përgjigjja e Viktimave, para. 8-9; Përgjigjja e ZPS-së, para. 5.

¹⁸ Shih nenin 46(1)-(2) të Ligjit. Shih gjithashtu Përgjigjen e Viktimave, para. 9; Përgjigjja e ZPS-së, para. 5.

ligjore për të dhënë leje për apelim të Vendimit mbi Pjesëmarrjen e Viktimave në Gjykatën Supreme.

10. Paneli gjithashtu rikujton se nuk i ka përcaktuar modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave për çdo situatë që mund të dalë gjatë procedurës së apelit, dhe mund t'i specifikojë të tilla modalitete më tej në të ardhmen, duke u mbështetur në parashtrime konkrete nga palët apo pjesëmarrësit në procedurë, ose *proprio motu*.¹⁹

11. Së fundi, Paneli vëren se në ballinën e Kërkesës, ku përcaktohet se kujt i shpërndahen parashtrimet, Mustafa nuk ka përfshirë mbrojtësen e viktimave, megjithëse në Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, Paneli ka përcaktuar se mbrojtësja e viktimave do të "vazhdojë të njoftohet për të gjitha materialet e nxjerra dhe/ose të shpërndara që i përkasin dosjes së çështjes, përfshirë parashtrimet e protokolluara, transkriptet dhe materialet provuese publike, konfidenciale apo rreptësisht konfidenciale, por duke përjashtuar çdo material që është *ex parte* mbrojtëses së viktimave".²⁰ Rrjedhimisht Paneli i rikujton Mustafës këtë vendim të tij dhe Udhëzuesin e Punës për Parashtrimet e Protokolluara, veçanërisht nenin 29(2)(j), i cili kërkon që pjesëmarrësit të cilëve do t'u shpërndahet një parashtrim i protokolluar, të përfshihen në ballinën e parashtrimit të protokolluar.²¹

III. VENDIM

12. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

HEDH POSHTË Kërkesën; dhe

¹⁹ Shih Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 14.

²⁰ Vendimi mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 11. Panel gjithashtu vendosi që mbrojtësja e viktimave të vazhdojë të informojë VPP-të për zhvillimet përkatëse në çështjen gjyqësore, në një mënyrë që nuk zbulon informacione jopublike. Shih Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, para. 11.

²¹ Shih Udhëzuesin e Punës për Parashtrimet, neni 29(2)(j).

UDHËZON Mustafën që të përmbushë Vendimin mbi Pjesëmarrjen e Viktimave dhe Udhëzuesin e Punës për Parashtrimet e Protokolluara, siç u theksua më lart në paragrafin 11.

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse**

E martë, 21 mars 2023

Hagë, Holandë